

PËRMBLEDHJE E PROSPEKTIT

FONDI I PENSIONIT VULLNETAR

CREDINS PENSION

Përmbledhja e Prospektit përmban informacione për të cilat duhet të jeni në dijeni përpara se të investoni, përfshirë dhe informacione mbi risqet. Gjithashtu jeni të lutur t'i referoheni edhe variantit më të plotë të Prospektit, miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Publikuar në Janar 2023

MBI FONDET E PENSIONEVE VULLNETARE DHE FONDIN CREDINS PENSION


Fondet e Pensioneve Vullnetare përfaqësojnë grupimin e fondeve të shumë investitorëve, të administruara nga Shoqëria Administruese, me qëllim optimizimin e kthimit nga investimi duke minimizuar riskun, për t’u siguruar anëtarëve të Fondit të ardhura më të larta dhe të sigurta në moshën e pensionit. Fondi i Pensionit Vullnetar është pjesë e njohur e sistemit ndërkombëtar të pensioneve. Ky lloj pensioni është krijuar për faktin se sistemet e zakonshme shtetërore të pensioneve nuk u sigurojnë njerëzve të ardhura të mjaftueshme kur arrijnë moshën e pensionit.

Fondi Credins Pension ka filluar aktivitetin në vitin 2012, dhe është nën administrimin e Shoqërisë Administruese të Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, Credins Invest sh.a. Monedha e fondit është Lek. Portofoli i fondit Credins Pension është strukturuar dhe është mbajtur në përputhje me objektivat e investimit, politikën e investimit dhe tiparet e riskut të shprehura në Prospektin e plotë të fondit, i publikuar në faqen zyrtare të Shoqërisë www.credinsinvest.com.

➤ INFORMACION MBI PERFORMANCËN

Vlera Neto e Aseteve	1,688,407,700.10
Çmimi i kuotës	1,618.5234
Numri i investitorëve	18,778
Kthimi nga investimi (31.12.2021 - 31.12.2022)*	3.47%

* Tarifa e administrimit është zbritur përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.




Çmimi i kuotës ka ndjekur një trend rritës të vazhdueshëm dhe fondi ka rezultuar me një normë kthimi 3.47% më 31 Dhjetor 2022.

FONDI I PENSIONIT CREDINS PENSION

Fondi është në monedhën vendase ALL

Banka depozitare: Tirana Bank



➤ PROFILI I INVESTITORËVE

Fondi i adresohet publikut si më poshtë:

- Investitorë që kërkojnë një investim me horizont afatgjatë.
- Investitorë me tolerancë të ulët për risk.
- Investitorë që kërkojnë likuiditet - ruajtja e një niveli të mjaftueshëm likuiditeti për t’iu përgjigjur të gjitha detyrimeve të pensioneve.
- Investitorë që kërkojnë siguri në investimet e tyre – manaxhimi profesional i Fondit dhe investimi i aseteve në instrumenta me kredibilitet të lartë, siç janë obligacionet.
- Investitorë institucionalë që kryejnë investime financiare dhe kërkojnë të përfitojnë nga avantazhet e këtij produkti.

➤ KARAKTERISTIKAT E FONDIT

Duke qenë se investon kryesisht në letra me vlerë të emetuara nga Republika e Shqipërisë, Fondi ka profil të ulët risku. Fondi nuk garanton një normë kthimi të përcaktuar. Normat e kthimit janë në varësi të ecurisë së tregut dhe mund të luhaten, duke ndikuar dhe në luhatjen e vlerës së investimit. Fondi aplikon një tarifë vjetore administrimi. Tarifa e administrimit të Fondit do të mbahet nga Vlera Neto e Aseteve të Fondit dhe do jetë në masën 2% në vit. Tarifa e administrimit i zbritet të ardhurës bruto të realizuar nga asetet e fondit.

Fondit nuk do t’i aplikohen tarifa të llojeve si më poshtë:

- kostot e mbajtjes së regjistrimit të kuotave, si dhe kostot e shpërndarjes së fitimeve;
- kostot e auditimit vjetor;
- tarifa e depozitarit dhe tarifa e AMF;
- tarifat e transferimit të aseteve.

Një tjetër tipar i Fondit është trashëgueshmëria. Nëse anëtari ndërron jetë përpara se të marrë pagesën e të gjitha aseteve të tij, asetet në llogarinë e tij do t’i shpërndahen trashëgimtarëve në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë trashëgiminë. Për informacion më të detajuar, jeni të lutur t’i referoheni Prospektit në faqen zyrtare të Shoqërisë: www.credinsinvest.com.

➤ **AVANTAZHET E FONDIT CREDINS PENSION**

• **Benefite Fiskale**

Kontributet janë të zbritshme nga paga bruto për efekt llogaritje tatimi deri në një limit të caktuar. Gjithashtu, investimet në fond janë të përjashtuara nga taksa mbi interesin dhe të ardhurat nga kapitali.

• **Investimi mund të fillojë edhe me shuma të vogla**

Shuma minimale e investimit është vetëm 1,000 Lekë. Gjithashtu, automatizimi i pagesave është një avantazh i kontratave profesionale, pasi pagesa mujore për kontribute vullnetare në skemën profesionale bëhet automatikisht nga punëdhënësi.

• **Transparencë**

Fondi ofron transparencë të lartë. Klienti pajiset me emër përdoruesi dhe fjalëkalim, në mënyrë që të aksesojë online në çdo kohë dhe pa limit llogarinë personale në fond, ku mund të ndjekë performancën e çmimit të kuotës dhe shpërndarjen e portofolit të investimeve të fondit.

• **Mundësia e kthimit të investimit të akumuluar në pagesa në formë pensioni**

Tërheqja e aseteve të akumuluar në llogarinë e anëtarit mund të bëhet kur anëtari plotëson kushtet e parashikuara në ligj. Në çdo rast tjetër kemi të bëjmë me tërheqje të parakohshme. Për informacion më të zgjeruar mbi tërheqjet e parakohshme, jeni të lutur t’i referoheni versionit të plotë të Prospektit, të publikuar në faqen zyrtare të Shoqërisë www.credinsinvest.com. Shoqëria Administruese do të ushtrojë edhe veprimtarinë e kryerjes së pagesave të pensionit. Pas daljes në pension, anëtari mund të zgjedhë nëse dëshiron të tërheqë të gjithë investimin e akumuluar apo ta tërheqë atë në pagesa në formë pensioni. Anëtarët inkurajohen të tërheqin investimin e akumuluar në pagesa në formë pensioni, sepse kështu mund të fitojnë sërish mbi investimin e mbetur në fond.

➤ **KU INVESTOHEN PARATË E ANËTARËVE?**

Në përputhje me strategjinë e investimit, të prezantuar në Prospektin e Fondit, Fondi do të investojë kryesisht në instrumenta afatgjata të emetuara nga Republika e Shqipërisë (obligacione). Të gjitha investimet do të kryhen duke mbajtur parasysh ruajtjen e vlerës së kapitalit dhe të një niveli të mjaftueshëm likuiditeti për të përmbushur të gjitha detyrimet e tashme dhe të ardhshme në momentin që këto të fundit bëhen të pagueshme.

➤ **ANËTARËSIMI NË FOND**

Anëtarët mund të anëtarësohen në fond nëpërmjet skemës individuale ose profesionale. Në skemën individuale vetëm individi kontribuon në fondin e pensionit vullnetar, në masën dhe periudhën e dëshiruar. Në skemën profesionale punëdhënësi ose/dhe punëmarrësi derdhin kontribute në fond në përfitim të punëmarrësve.

➤ **ILUSTRIM: BLERJA E KUOTAVE**

Çmimi i kuotës së pensionit në ditën e kontributit:	1,000 Lek
Kontributi:	3,000.00 Lek
Numri i kuotave të anëtarit në Fond: (ALL 3,000.00/ALL 1,000.00)	3 kuota

Ky transaksion regjistrohet në llogarinë individuale të anëtarit të Fondit e cila mbahet pranë Depozitarit. Çmimi i kuotës në një fond pensioni llogaritet çdo ditë. Çdo blerje apo shlyerje kuotash në Fond do të bëhet në lekë. Vlera në para e investitorit del duke shumëzuar numrin e kuotave të tij me çmimin për kuotë.

Nëse pas disa kohësh çmimi i kuotës do të rritet nga ALL 1,000.00 në ALL 1,050.00, vlera e asetëve të anëtarit në Fond (pa tarifën e administrimit) do të jetë ALL 1,050.00 x 3 kuota = ALL 3,150.00.

➤ **TRAJTIMI FISKAL**

Fondi është një grup asetesh, i krijuar në bazë kontrate dhe pa personalitet juridik, për rrjedhojë nuk i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat ose taksës mbi vlerën e shtuar. Në lidhje me trajtimin fiskal të kontributeve (të bëra nga anëtarët ose nga punëdhënësit, dhe të kontributeve të marra nga anëtarët), Shoqëria vepron në përputhje me ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 Për Fondet e Pensionit Vullnetar. Për më tepër detaje mbi trajtimin fiskal, jeni të lutur t’i referoheni versionit të plotë të Prospektit, të publikuar në faqen zyrtare të Shoqërisë www.credinsinvest.com.

➤ **RISQET E INVESTIMIT NË FOND**

Ecuria e normës së kthimit të Fondit varet nga lëvizja e normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të Republikës së Shqipërisë. Historikisht këto norma kanë treguar luhatshmëri të ulët.

Risk i ulët

Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë

Përfitimet tipike më të larta

1	2	3	4	5	6	7
---	---	---	---	---	---	---

Fondi Credins Pension ka profilin më të ulët të riskut, në nivelin 1. Çdo investim apo normë kthimi e caktuar shoqërohet me riskun përkatës. Sa më e lartë të jetë norma e kërkuar e kthimit aq më i lartë është risku i ndërmarrë, dhe anasjelltas. Risku i tregut, risku i kreditit dhe ai i likuiditetit janë disa nga risqet kryesore ndaj të cilave fondi ekspozohet. Për më tepër informacion mbi risqet e investimit në fond, ju ftojmë të lexoni Prospektin e publikuar në faqen e Shoqërisë: www.credinsinvest.com

➤ **SI KOMUNIKOJMË ME ANËTARIN?**

- 1) Faqja zyrtare e Shoqërisë është mjaft e pasur me informacion dhe përditësime lidhur me shoqërinë dhe fondet;
- 2) Vlera Neto e Aseteve dhe çmimi i Fondit publikohen me bazë ditore në faqen zyrtare të shoqërisë;
- 3) Raportet mujore mbi ecurinë e Fondit publikohen në faqen zyrtare çdo muaj;
- 4) Për çdo kërkesë apo informacion shtesë çdo anëtar inkurajohet të kontaktojë me analistët financiarë të Shoqërisë.

Performanca e kaluar nuk është një udhëzues, premtim apo garanci për performancën e ardhshme dhe nuk duhet të jetë faktori i vetëm i shqyrtimit gjatë zgjedhjes së një fondi. Të gjitha investimet financiare përfshijnë një element të riskut. Prandaj, vlera e investimit tuaj dhe të ardhurat nga ajo do të ndryshojnë. Nivelet dhe bazat e taksimit mund të ndryshojnë herë pas here. Për informacion shtesë, jeni të ftuar të lexoni Prospektin e Fondit si dhe të vizitoni faqen zyrtare të shoqërisë www.credinsinvest.com.